



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 562 / prot.  
//

Tiranë më 10.06.2021

**VENDIM**

Nr. 30 , datë 10.06.2021

**PËR KONTROLLUESIN “SIMETRIX SOLUTIONS ” SHPK**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “*Simetrix Solutions*” SHPK,

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 43, datë 13.04.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit “*Simetrix Solutions*” SHPK (në vijim, “*Kontrolluesi*”), me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi.

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit, konstaton se:

1. “*Simetrix Solutions*” SHPK, ushtron veprimtari tregtare “*call center*” dhe “*shërbim klienti*”, në emër dhe për llogari të shoqërisë “*Barrister Global Services Network*”, me seli në Luiziana, SHBA. Gjatë ushtrimit të aktivitetit “*Simetrix Solutions*” SHPK, përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve “*punëmarrës*” dhe “*kandidatë për punë*”. Të dhënat e subjekteve përpunohen manualisht si dhe nëpërmjet mjeteve elektronike.

2. Në kuadër të trajtimit të ankesave të subjekteve të të dhënave, ku pretendohet se janë kontaktuar për qëllime fushate elektorale, u konstatua se numrat dhe \_\_\_\_\_ janë në pronësi të kontrolluesit. Nga verifikimi i provave rezulton se thirrjet kanë ardhur nga këto dy numra.

Gjatë hetimit administrativ, përfaqësuesi i kontrolluesit fillimisht ka deklaruar se këto numra i ka vendosur në dispozicion të disa subjekteve politike, por në përfundim të procesit të hetimit administrativ, ka ndryshuar qëndrim duke deklaruar se këto numra nuk janë përdorur nga subjekte politike por, janë përdorur për të nxjerrë sondazhe për rezultatet e zgjedhjeve nga grupe interesi dhe jo subjekte politike.

Lidhur me rregullimin e marrëdhënieve me palët e treta (subjekte politike apo grupe interesi), në rastet kur u vihen në dispozicion mjete, infrastrukturë, mundësi veprimi, përdorimin e aseteve të kontrolluesit (në rastin konkret numrave VoIP), përfaqësuesi i kontrolluesit ka deklaruar se nuk është angazhuar për të rregulluar në ndonjë formë ligjore këtë lloj marrëdhënie dhe për pasojë, është në pamundësi të vendos në dispozicion dokumentacion tjetër.

Nga verifikimet e kryera rezulton se (referenca për informacionin administruar në dosjen e hetimit administrativ), numrat virtual të kontraktuara nga shoqëria e telekomunikacionit, janë VoIP (transmetim zëri nëpërmjet protokolleve të internetit - voice over internet protocoll). Shërbimet VoIP, konvertojnë zërin në një sinjal digjital i cili qarkullon në internet. Nëse thirret një numër normal telefoni, sinjali konvertohet në një sinjal telefonik të rregullt përpara se thirrja të arrijë destinacionin. VoIP gjithashtu mund të lejojë kryerjen e telefonatave të drejtpërdrejta nga një kompjuter, nga një pajisje telefonike speciale VoIP ose një telefon tradicional i lidhur me një adaptor të përshtatshëm. Numrat VoIP mund të konfigurohen dhe vihen në funksionim në aplikacione të ndryshme të tilla si "Vicidial" (instalim lokalisht në ambientin e ushtrimit të aktivitetit), në "cloud" dhe të administrueshme nga aplikacione si ZOIPER etj.

Zakonisht të tilla sisteme / mjete komunikimi, përdoren për qëllime biznesi për kryerjen e telefonatave në masë, për qëllime sondazhesh apo marketingu të drejtpërdrejtë.

Me vënien në funksion të një sistemi të tillë komunikimi, është e mundur të krijohen baza të dhënash të kategorizuara dhe me përmbajtje të tilla si emër, mbiemër, nr. telefoni, nëse numri i subjektit është aktiv, zëri i subjektit të thirrur, koha e komunikimit, përmbajtja e komunikimit, herët e komunikimit, si dhe informacione dhe të dhëna të tjera rreth subjektit, të cilat mund të veçohen gjatë komunikimit dhe në varësi të temës së komunikimit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, "Simetrix Solutions" SHPK, në cilësinë e "Kontrolluesit", është përgjegjës për marrjen e masave organizative dhe teknike të

përshtatshme, për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi, sipas parashikimit në nenin 27 të Ligjit.

Në germën "e", të pikës 2, të nenit 27 të ligjit, parashikohet detyrimi i kontrolluesit i cili duhet të aplikojë procedura teknike dhe organizative të përshtatshme, ndër të tjera, për vënien në punë të pajisjeve të përpunimit të të dhënave vetëm me autorizim, me qëllim që çdo mjet/mekanizëm të sigurohet me masa parandaluese ndaj vënies së paautorizuar në punë.

Numrat VoIP të cilat kontrolluesi i ka kontraktuar nga shoqëria e telekomunikacionit, për qëllime dhe në funksion të aktivitetit të vet, konsiderohen asete dhe/ose mekanizma të cilat, mbasi konfigurohen në platforma të përshtatshme (të cilat mund të konfigurohen dhe instalohen lokalisht në një server në ambientet e kontrolluesit dhe/ose në platformat cloud), mundësojnë kryerjen e komunikimeve elektronike me numrat aktiv të rrjeteve mobile.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, veprimet/mosveprimet e kontrolluesit janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 5, 20 dhe 27 të Ligjit, si dhe Udhëzimit 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012, mbi *"Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi"* i ndryshuar (në vijim, *"Udhëzimi nr. 19"*).

3. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezultoi se Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim të përpunimit të të dhënave personale, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe për realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

Më datë 26.04.2021, Kontrolluesi ka paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit, deklaratimet në *"Formularin e Njoftimit"* mbi përpunimin e të dhënave për të cilat është përgjegjës.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës, i cili u nënshkrua nga përfaqësuesi i Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"*, Kontrolluesi

është fluar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Kontrolluesi nuk është paraqitur në seancë dëgjimore, në datën dhe orën e caktuar. Lidhur me pretendimet e kontrolluesit mbi konstatimet e evidentuara nga grupi i kontrollit në procesverbalin e hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit vlerëson se:

Shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të nenit 39, pika 1, germat "a", "ç", "d" dhe "dh" të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- dh) Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës. Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, përfshijnë elemente thelbësore të Ligjit, lidhur me garantimin e parimeve të përpunimit të të dhënave, të drejtave të subjekteve dhe detyrimeve në tërësi të Kontrolluesit Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 20, 21, 27, 29, 30, 32, 39 (pika 1, germat "a", "ç", "d" dhe "dh"), si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

#### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin kreun II të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit;

3. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 300 000 (treqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit;
4. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit;
5. Kontrolluesi të përfshijë në marrëveshjet me përpunuesit përkatës, detyrimet sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr.19 të Komisionerit;
6. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përditësimin e "Njoftimit" pranë zyrës së Komisionerit, në rast të ndryshimit të gjendjes së përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit;
7. Kontrolluesi, të marrë masat për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, sipas detyrimeve të parashikuara në nenin 27 të ligjit;
8. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
  - (i) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e parashikuara në pikën 5;
  - (ii) në vazhdimësi, detyrimet e parashikuara ne pikat 6 dhe 7;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

9. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
10. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 10.06.2021.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

